

VENDIM
Nr.196, datë 24.3.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “LIDHJA E RRUGËS KOMBINAT ME URËN E BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë.22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lidhja e rrugës Kombinat me Urën e Beratit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë truall 1935 (një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) m², me vlerë 5 998 500 (pesë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, si dhe për objekte me vlerë 17 121 076 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e një mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 23 119 576 (njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale në shumën 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 23 119 576 (njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Për pasuritë për të cilat në kolonë është bërë shënimi “Proces legalizimi”, pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe të jetë bërë regjistrimi në ZRPP, i cili do të vërtetohet zyrtarisht nga ZRPP-ja respektive, bazuar në dokumentacionin e pronësisë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, do të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Proces legalizimi”, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe të jetë bërë regjistrimi në ZRPP.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE

SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E TROJEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “LIDHJA E RRUGËS HYRËSE KOMBINAT ME URËN E RE BERAT”

nNr.	Pronari			ZZ.K.	Nr. pas.	Sip. m ²	Tokë truall	Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Çmimi lekë/m ²			
1	Fitime	Fitim	Molishti	8501	10/263	550	3100	1705000	1705000	Konf ZRPP
2	B/Pronarët		Drenova	8501	10/189	1041	3100	3227100	3227100	Konf ZRPP
3	B/Pronarët		Drenova	8501	10/185	143	3100	443300	443300	Konf ZRPP
4	Kamber	Hajro	Hasani	8501	9/194	140	3100	434000	434000	Konf ZRPP
5	B/Pronarët		Kurteshi	8501	10/228	61	3100	189100	189100	Konf ZRPP
		Shuma				1935		5998500	5998500	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “HYRJE BERAT”

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr. pasurisë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				
1	Kamber	Hajro	Hasani	8501	9/194	6611687	Konf ZRPP
2	Shpëtim	Deli	Zanaj	8501	10/35	1097745	Konf ZRPP
3	Lulzim	Myslim	Balla	8501	11/13	577350	Konf ZRPP
4	Klei	Edison	Çobo	8501		3444659	Në proces legalizimi
5	Ali	Hajro	Hasani	8501		2166724	Në proces legalizimi
6	Rushit	Ibrahim	Azizi	8501		1327105	Në proces legalizimi
7	Ylmi	Sabri	Dushku	8501		324536	Në proces legalizimi
8	Robert	Haredin	Çela	8501		1571270	Në proces legalizimi
	Shuma					17121076	